



Drejtoria e Arsimit/Direkcija za Obrazovanje/Eğitim Müdüriyeti

Duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 5 nënparagrafi 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/ 2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komisioni rekrutues dhe përzgjedhës, nxjerr:

V E N D I M
PËR MOS VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË REKRUTIMIT

1. **Nuk vazhdohet** procedura e rekrutimit sipas konkursit të shpallur publik nga Drejtoria e Arsimit, 05 Nr. 99859 e datës: 21.09.2023 për vendet e punës:

Nr.	Shkolla	Lënda
1	Sh.F.M.U."Liria"	Fizikë
2	Sh.F.M.U."Nazim Hikmet"	Fizikë
3	Sh.F.M.U."Dëshmorët e Kombit"	Matematikë
4	Sh.F.M.U."Abaz Ajeti"	TIK
5	Sh.F.M.U."Fetah Qerimi"	Matematikë
6	Sh.M.L."Adem Kastrati"	Grafikë
7	Sh.M.L.M. "Dr.Asallan Elezi"	Psikologji

2. Konkursi për këto vende të punës duhet të përsëritet brenda afatit të paraparë ligjor.
3. Vendimi hyn fuqi me datën: 09.11.2023.

A r s y e t i m

Drejtoria Komunale e Arsimit përmes përgjegjësve kompetent, gjatë fazës së verifikimit paraprak të aplikacioneve të kandidatëve konkurrues, ka konstatuar se në konkursin e publikuar nga DKA-ja me datë 21.09.2023, nuk kemi kandidatë të mjaftueshëm për të vazhduar më tutje me procesin e rekrutimit për vendet e punës sipas pikës 1 të diapozitivit të këtij vendimi.

Avdil Islami, Kryetar i komisionit,

